



**Autoriteti Shtetëror për  
Informacionin Gjeohapësinor**



**Agjencia Shtetërore  
e Kadastrës**

Nr. 544/prot., Tiranë, më 25.09.2024  
12

11182/1  
Nr. \_\_\_ prot., Tiranë, më 25.09.2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

dhe

**AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Tiranë, sot më datë 25.09,2024, nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

**Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)**, institucion publik qendror me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Znj. Vilma TOMÇO, Drejtor i Përgjithshëm,

(në vazhdim “ASIG”)

dhe

**Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK)**, institucion publik qendror, me adresë: Rruga Dora D'Istria, Nr. 2, Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, përfaqësuar nga Znj. Lorena Goxhobelli, Drejtor i Përgjithshëm,

(në vazhdim “ASHK”)

Këtu e më poshtë, ASIG dhe ASHK individualisht referuar si “Palë” dhe së bashku “Palët”.

**Të vetëdijshëm:** Për nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të frymës së bashkëpunimit në realizimin me sukses, me cilësi të detyrimeve ligjore të parashikuar nga ligji 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” dhe jo vetëm;

**Në mbështetje të:** Ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, VKM-së nr. 321, datë 27.04.2016 “Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri-Tema: Parcelat Kadastrale””, VKM-së nr. 359, datë 11.05.2016 “Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri-Tema: Ndërtesat”” dhe VKM-së nr.547, datë 28.09.2023 “Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore të GIS-it Kombëtar”.

## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje është forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve të bashkëpunimit mes palëve, për përdorimin dhe shkëmbimin efektiv të informacionit gjeohapësinor, zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes trajnimeve sistematike, me qëllim përmirësimin e cilësisë së publikimit dhe përditësimit të të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

## **Neni 2**

### **Fushat e bashkëpunimit**

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj marrëveshje, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

2.1 Shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore sipas standardeve shtetërore të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në kohë optimale duke trajtuar me prioritet kërkesat e palëve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

2.2 Komunikimin sistematik në kuadër të publikimit dhe përditësimit të të dhënave gjeohapësinore në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe ofrimin e asistencës në realizimin me sukses të kësaj pike përmes caktimit të personit të kontaktit.

2.3 Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta veçanërisht në fushën e trajnimit të stafëve teknike lidhur me zbatimin e standardeve shtetërore të gjeoinformacionit mbi temat: “Parcelat kadastrale” dhe “Ndërtesat”.

2.4 Pjesëmarrje e ndërsjellë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët me interes në fushën e gjeoinformacionit.

### **Neni 3**

#### **Angazhime të ASIG**

3.1 ASIG angazhohet që të vërë në dispozicion të ASHK informacionin gjeohapësinor që disponon (ortoimazheri, hartë bazë etj.), duke trajtuar me prioritet dhe në kohë sa më optimale, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe volumin e të dhënave që parashtrihen në kërkesat që vijnë nga ky institucion.

3.2 ASIG merr përsipër të ofrojë ndaj ASHK lehtësi në aksesimin e të dhënave gjeohapësinore duke vënë në dispozicion shërbime të dedikuara.

3.3 ASIG angazhohet të asistojë dhe trajtojë stafin teknik të ASHK lidhur me zbatimin e standardeve shtetërore të gjeoinformacionit për temat: “Parcelat kadastrale” dhe “Ndërtesat”, për të cilat ASHK është autoritet publik përgjegjës si dhe në përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar.

3.4 ASIG merr përsipër të caktojë një person kontakti, i cili do të adresojë tek strukturat përkatëse brenda ASIG, problematikat e ardhura nga ASHK lidhur me aksesimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

3.5 ASIG angazhohet në diskutimin dhe zgjidhjen e çdo çështjeje me interes të përbashkët me ASHK, pas diskutimit dhe dakortësimit të personave të kontaktit të dy institucioneve.

### **Neni 4**

#### **Angazhime të ASHK**

4.1 ASHK merr përsipër të vërë në dispozicion të ASIG informacionin e plotë gjeohapësinor nga momenti fillestar i regjistrimit që disponon për zonat kadastrale, që nuk janë të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.

4.2 ASHK, si autoritet publik përgjegjës për temat: “Parcelat kadastrale” dhe “Ndërtesat”, siguron ndërveprimin e sistemit të GIS Kadastrës me Gjeoportalin Kombëtar për këto të dhëna.

4.3 ASHK angazhohet të trajtojë me prioritet kërkesat që vijnë nga ASIG, në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale të këtij institucioni, përmes caktimit të një personi kontakti.

4.4 ASHK angazhohet të informojë dhe ftojë ASIG në çdo aktivitet apo projekt që ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin sa më të mirë të kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet nga momenti i nënshkrimit të saj.

5.2 Secila palë mund të zgjidh marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër.





## Neni 6

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Palët do të zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet tyre me mirëkuptim. Në rast të kundërt zbatohen përcaktimet e legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile.

## Neni 7

### Dispozita përfundimtare

7.1 Kjo marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobi të mbarëvajtjes së saj, me propozimin e secilës palë.

7.2 Çdo njoftim dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshime apo shtesa të përmbajtjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore.

7.3 Palët caktojnë personat e kontaktit, të cilët monitorojnë zbatimin e kësaj marrëveshje si dhe i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimin eventual të tyre.

#### **Për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor:**

**Person Kontakti:** DRITAN DOMI

**E-mail:** dritan.domi@asig.gov.al

**Mobile:** +355682038230

#### **Për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës:**

**Person Kontakti:** ANDI PROKO

**E-mail:** andi.proko@ashk.gov.al

**Mobile:** +355694403444

7.4 Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet sot më, 25.09.2024 dhe fillon menjëherë zbatimin e saj.

Nënshkrimi

Znj. Vilma TOMÇO

Drejtor i Përgjithshëm

Autoriteti Shtetëror për Informacionin

Gjeohapësinor

Nënshkrimi

Znj. Lorena GOXHOBELLI

Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia Shtetërore e Kadastrës